

PROGRAMI BUXHETOR
AFATMESEM
2018-2020



Tirana

		Faqe
	Hyrje	2
KAPITULLI I	Procesi i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Roli i tij	3
KAPITULLI II	Prioritetet Afatmesme 2018 - 2020	8
KAPITULLI III	Parashikimet Buxhetore Afatmesme 2018 - 2020	14
III.1	Të Ardhurat e Bashkisë së Tiranës për Periudhën 2018 – 2020	14
III.2	Transfertat nga Buxheti i Shtetit	30
III.3	Burime të tjera financimi / Donacione	33
III.4	Parashikimi i shpenzimeve për Periudhën 2018 - 2020	36

HYRJE

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë së Tiranës është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, bazuar në funksionet e pushtetit vendor të përcaktuara në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht Bashkia e Tiranës. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program buxhetor. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse.

Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioritetëve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2018-2020 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e të 24 njësive administrative dhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për vitet 2015-2019.

Projekt-buxhetet bazohen në vizionin tonë për Tiranën e së ardhmes, e cila para së gjithash duhet të jetë një qytet i jetueshëm, me infrastrukturë moderne e transport publik cilësor, me shërbime efikase e cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore të larmishme e me hapësira të dedikuara për fëmijët, të moshuarit, këmbësorët e çiklistët. Ne besojmë se pavarësisht problemeve të shumta, Tirana fsheh një potencial të jashtëzakonshëm ekonomik, social e kulturor.

KAPITULLI I PROCESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë e Tiranës, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë të identifikuar në Programin e Bashkisë së Tiranës dhe në dokumentat e tjerë strategjikë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Rol domethënës në hartimin e kësaj PBA-je kanë luajtur edhe qytetarët e Tiranës, të cilët në kuadër të takimeve “Buxheti me pjesëmarrje” kanë shprehur prioritetet e tyre për shpenzimet publike.

Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- a. Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
- b. Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:
 - Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
 - Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë së Tiranës, dhe prioritetëve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
- Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritetë të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;
- Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimit të burimeve;
- Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2015-2019 me nevojat e qytetarëve duke i përkthyer në politika vendore dhe konkretizuar në plane shpenzimesh.

Ky dokument synon të informojë Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe publikun e gjerë lidhur me planet afatmesme të shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Dokumenti synon t'i japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh në periudhë afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe financiare të Bashkisë së Tiranës.

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, interesa),
- b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- b. Institucionet e varësisë

Konsultimi i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Në mbylljen e vitit kalendarik 2017, i cili shënon një tjetër arritje historike për Bashkinë e Tiranës, në aspektin e performancës financiare dhe shtrirjes së investime publike në çdo cep të Tiranës, janë realizuar sërish dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin 2018-2020.

Bashkia e Tiranës i jep përparësi thelbësore përfshirjes qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje, për sa i përket projekteve, investimeve dhe shërbimeve që ky institucion garanton ndaj qytetarëve të kryeqytetit. Vendimmarrjen me pjesëmarrje Bashkia e zbaton edhe në bazë të parimeve themelore të funksionimit të një qeverisje demokratike dhe të shtetit të së drejtës, parime të tilla si: parimi i transparencës, gjithëpërfshirës, zbatimit të ligjshmërisë, subsidiaritetit etj.

Dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin me pjesëmarrje u realizuan edhe këtë vit në 24 njësitë administrative, ku u paraqitën projektet e nisura tanimë, të cilat do të vijojnë edhe gjatë vitit 2018, si edhe ato risi në punë dhe investime publike, të cilat parashikohen të financohen dhe realizohen gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu u morrën në kosideratë kërkesat dhe sugjerimet e banorëve për përmirësimin e cilësisë së jetesës sipas nevojave për secilën njësi.

U realizua sondazhi për qytetarët, qëllimi i të cilit ishte të evidentojë mendimin qytetar rreth fushave dhe zërave të investimeve, të propozuara nga Bashkia e Tiranës në projektbuxhetin e vitit 2018.

Nga totali i të intervistuarve pjesëmarrës në këtë sondazh, 50.2% e tyre ishin femra dhe 49.8% meshkuj. Vihet re që grup-moshat 30 – 65 vjeç kanë përqindjen më të lartë, konkretisht 76.7%, gjë që tregon një interesim i lartë të qytetarëve për projektbuxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2018

Për sa i përket informacionit të ofruar në dëgjesat publike 47% e qytetarëve e kanë cilësuar të mjaftueshëm, 35% të mirë, 15% neutral dhe vetëm 3% si të pamjaftueshëm.

Nevojat dhe sugjerimet e ardhura nga qytetarët variojnë në funksion të zonave të banimit dhe problematikave të ndryshme që këto paraqesin, sipas shembujve të mëposhtëm:

Në Njësinë Administrative Nr. 1, qytetarët e intervistuar (në raport me totalin e qytetarëve që u përfshinë në sondazh) u shprehën se investimet duhet të përqendrohen në biblioteka dhe qendra kulturore (14%), hapësira çlodhëse (10%), gjelbërimi dhe kënde lojërash (përkatësisht me nga 9%).

Njësia Administrative Nr. 2, paraqet se nevojat për investim janë më së shumti për hapësira parkimi (8% e totalit të intervistuarve), si edhe në gjelbërim, infrastruktura rrugore, trotuare/rrjet për biçikleta, terrene për veprimtari sportive (përkatësisht me nga 7% secili zë), si edhe kënde lojërash dhe shërbim social (me nga 6%).

Në Njësinë Administrative Nr. 3, investimet në projektbuxhetin e vitit 2018 duhet të jenë sipas kësaj renditjeje përparësish: strehimi (9%), shërbim social (7%), biblioteka, qendra kulturore, rigjenerimi i objekteve të vjetra, punësim dhe formim profesional (me nga 6%).

Në Njësinë Administrative Nr. 4, parësore për investimet e vitit të ardhshëm buxhetor konsiderohet strehimi, gjelbërimi dhe këndet e lojërave (përkatësisht me nga 7%), por edhe terrenet sportive, parkimi,

trotuare dhe rrjeti i biçikletave, nxitja e biznesit të vogël, punësimi dhe formimi profesional, hapësirat çlodhëse (përkatësisht me nga 6%).

Njësia Administrative Nr. 5, bën dallim nga njësitë e tjera për shkak të kërkesave të shumta për investime në biblioteka dhe qendra kulturore (16%), si edhe hapësira çlodhëse, shërbim social dhe promovim të trashëgimisë kulturore (9%), por edhe parkim, trotuare/rrjet biçikletash, gjelbërim (me nga 8%).

Në Njësinë Administrative Nr. 6, qytetarët pjesëmarrës në dëgjesë, janë shprehur se investimet në këtë njësi duhet të jenë më së shumti për sinjalistikën rrugore (11%), tregjet, trotuare/rrjetin e biçikletave, çerdhe (përkatësisht me nga 9% secila fushë), rigjenerimi i objekteve të vjetra dhe gjelbërimi (përkatësisht me nga 8%).

Në Njësinë Administrative Nr. 7, vërehet se zëri më i nevojshëm për investim është konsideruar parkimi (në 28% të rasteve të intervistuar), biblioteka dhe qendra kulturore (27%), hapësira çlodhëse (25%), promovimi i trashëgimisë kulturore (24%).

Në Njësinë Administrative Nr. 8, vërehet se kryesisht shihet si parësore strehimi, sinjalistika rrugore, sistemim dhe asfaltim i rrugëve dhe shkolla (përkatësisht me nga 4%).

Në Njësinë Administrative Nr. 9, përparësi për t'u përfshirë në projektbuxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2018 e zënë kanalizimet dhe gjelbërimi (përkatësisht me nga 5%), por edhe sinjalistika rrugore, nxitja e biznesit të vogël, punësimi dhe formimi profesional, pastrimi (me nga 4% secili).

Në Njësinë Administrative Nr. 10, është parësore hapësira për vende parkimi (evidentuar në 16% të kampionimit).

Në Njësinë Administrative Nr. 11, konsiderohet si më parësore orientimi i investimeve tek strehimi (10%), rrjeti ujësjellës (9%), terreneve dhe veprimtarive sportive, trotuare dhe rrjetin e biçikletave (përkatësisht me nga 8%).

Në Njësinë Administrative Baldushk, konsiderohet si prioritare investimet në terrene dhe veprimtari sportive, grumbullim dhe riciklim mbetjesh si edhe në kënde lojërash (përkatësisht me nga 6%), por edhe transporti urban dhe tregjet (me nga 5%).

Në Njësinë Administrative Bërzhitë, është evidentuar si parësore përqendrimi i investimeve në projektbuxhetin e vitit 2018 në transport urban (12%), ujësjellës dhe kanalizime (me nga 7%).

Në Njësinë Administrative Dajt, banorët konsiderojnë si zë parësor rigjenerimin e objekteve të vjetra (5%), si edhe promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit, trotuare/ rrjet biçikletash, sistemim dhe asfaltim rrugor, grumbullim dhe riciklim mbetjesh, si edhe shkolla (përkatësisht me nga 4% secili zë).

Njësia Administrative Vaqarr, ka nënvizuar si më emergjente transportin urban dhe këndet e lojërave rekreative (përkatësisht me nga 7%), si edhe rrjeti ujësjellës (6%), kanalizimet, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve, kopshte e shkolla (përkatësisht me nga 5% secili).

Në Njësinë Administrative Shëngjergj, banorët kanë shënuar si parësore ndër zërat për investim gjatë vitit 2018 promovimin e trashëgimisë kulturore (10%), por edhe grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve (8%).

Në Njësinë Administrative Pezë, kërkesat janë më së shumti për bibliotekë dhe qendra kulturore (8%), si edhe për kënde lojërash rekreative (6%).

Njësia Administrative Petrelë, dhe përfaqësuesit e saj kanë shënuar si zërin më të rëndësishëm në investimet e parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2018 pikërisht transportin urban (12%).

Njësia Administrative Ndroq, ka cilësuar si zë më të rëndësishëm, për investim gjatë vitit të ardhshëm tregjet dhe rrjetet e tregtisë (10%), si edhe sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve (6%).

Në Njësinë Administrative Krrabë, banorët kanë konsideruar si investimin më të domosdoshëm gjatë vitit 2018 në këtë njësi, tregjet dhe rrjetet e tregtisë dhe grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve (6%), si edhe bibliotekë dhe qendra kulturore (5%).

Në Njësinë Administrative Kashar, banorët kanë shënuar si parësore në këtë njësi investimet në rrjetin ujësjellës, çerdhe dhe kopshte (me nga 6%), të cilat përbëjnë edhe shtyllat më problemore për komunitetin e kësaj njësie

Në Njësinë Administrative Farkë është konsideruar si nevojë parësore për përfshirje në projektbuxhetin e vitit 2018, transporti publik (10%), kënde lojërash (7%) ujësjellës dhe kanalizime, sinjalistikë rrugore, sistemim dhe asfaltim, çerdhe e kopshte (përkatesisht me nga 6%).

Vërehet se trendi i nevojave për investime në të gjithë Bashkinë e Tiranës është shënuar për sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve (56%), kopshte (52%), çerdhe (51%), shkolla (50%), punësim dhe formim profesional (51%), nxitje e biznesit të vogël (51%), kanalizime (50%), ujësjellës (49%).

Për sa më sipër, sugjerimet e ardhura nga qytetarët variojnë në funksion të zonave të banimit dhe problematikave të ndryshme që këto paraqesin:

Në njësitë administrative urbane kërkesat janë të shumta për sistemim, asfaltim dhe ndriçim rrugësh, ndërtim shkollash, kopshtesh dhe çerdhesh por edhe për punësim dhe nxitje të bizneseve si edhe më shumë vende parkimi.

Në njësitë administrative rurale kërkesat janë më të shumta për kanalizime, mirëmbajtjen e shkollave dhe kopshteve, përmirësimin e transportit apo largimin e mbetjeve në disa njësi.

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2018-2020 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Tiranës dhe në Programin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2015-2019.

➤ **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Objektivi themelor i PBA-së 2018-2020 do të jetë garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të Tiranës, për të përmirësuar jetesën e brezave të sotëm e për të garantuar mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Programet Buxhetore të dy viteve të shkuara kanë arritur tashmë objektivat e rikthimit të Tiranës në punë dhe kthimit të saj në një qytet të jetueshëm. Kanë përfunduar disa nga projektet e mëdha strategjike; është ndërhyrë në pjesën dërrmuese të lagjeve të qytetit me projekte rigjenerimi urban; është siguruar pastërtia e qytetit dhe reduktuar ndotja; është shtuar sipërfaqja e gjelbër; është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura në të gjithë çerdhet e kopshtet e qytetit; janë krijuar hapësira të reja rekreacionale; është rigjallëruar jeta kulturore dhe masivizimi i sporteve.

Hartimi i buxhetit të ardhshëm mbështetet në vijimësinë e çdo përmirësimi të deritanishëm dhe politikave të reja në drejtim të:

- Ndërtimit të shkollave të reja dhe përmirësimit të infrastrukturës në objektet arsimore;
- Nxitjes së zhvillimit ekonomik, punësimit e sipërmarrjes;
- Përmirësimit të infrastrukturës urbane;
- Nxitjes së transportit alternativ dhe miqësor me mjedisin;
- Rritjes së sipërfaqeve të gjelbra e parqeve dhe shtimit të hapësirave rekreacionale;
- Ndhimesës së bujqësisë dhe nxitjes së zhvillimit rural dhe turizmit;
- Ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, etj.
- Mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes,
- Rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore;
- Nxitjes së jetës kulturore e sportive në qytet;

➤ **Projekte Strategjike:**

Programet Buxhetore të dy viteve të mëparshme kanë përfshirë një sërë projektësh strategjike, të cilat sot janë të realizuara:

- Projekti i Rigjenerimit Urban të Pazarit të Ri dhe Sheshit Avni Rustemi;
- Projekti i Bulevardit të ri dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës nga Km. +0.000 deri +0.500;
- Projekti i Ndërtimit të Unazës së Vogël ;
- Projekti i Rikonstruksionit të Sheshit ;
- Projekti për Rehabilitimin e Parkut të Madh të Tiranës;

Gjithashtu, vijojnë ose janë drejt përfundimit disa projekte të tjera strategjike, të nisura tashmë:

1. Shkollat e reja

Në Bashkinë Tiranës gjenden gjithsej 191 shkolla publike. 61 shkolla kanë më shumë nxënës se sa kapaciteti i tyre maksimal dhe 57 shkolla e zhvillojnë mësimin me dy turne. Për t'u dhënë një zgjidhje përfundimtare këtyre tre problemeve, duhet të ndërtohen 17 shkolla të reja, nga të cilat 10 shkolla të ciklit 9-vjeçar, të cilat do të përfshijnë edhe ambiente për kopshte brenda tyre, dhe 7 shkolla të ciklit të mesëm të lartë. Në NJA2 do të ndërtohen 3 shkolla të reja, dy 9 vjeçare dhe një e mesme. Në NJA5 do të ndërtohet një shkollë 9 vjeçare. Në NJA7 do të ndërtohet një shkollë e mesme. Në NJA8 do ndërtohet një shkollë 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në NJA9 do ndërtohet një shkollë 9 vjeçare dhe një e mesme. Në NJA11 do ndërtohen dy shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në NJA Dajt do ndërtohet një shkollë e mesme. Në NJA Farkë do ndërtohet një shkollë 9 vjeçare. Në NJA Kashar do ndërtohetn dy shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Të gjitha shkollat 9 vjeçare do të kenë edhe kopësht të integruar.

2. Pylli orbital

Pylli Orbital është një projekt i rëndësishëm për krijimin e një mushkërie urbane për qytetin e Tiranës. Pylli orbital do të shërbejë si një rrip që kufizon zhvillimin e dëndur urban dhe ndan Tiranën urbane me Tiranën periurbane dhe rurale. Plani i Përgjithshëm Vendor planifikon mbjelljen e 2 milion pemëve në këtë brez të ri të gjelbër të qytetit me qëllim që brezat e ardhshëm të qytetareve të Tiranës të kenë akses në një park linear që rrethon qytetin si dhe rritja e dëndësisë së gjelbërimit urban pritet të ketë një efekt të drejtpërdrejt në cilësinë e ajrit. Kjo ndërhyrje, së bashku me sheshin qendror pedonal, rrjetin minimal të biçikletave dhe qendrat e reja urbane të Tiranës pritet të kenë një impakt të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të banorëve të qytetit tonë.

Pylli Orbital tashmë ka nisur nga puna dhe është sërish pjesë e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, ku përveç investimeve të Bashkisë kemi pasur edhe ndihmën e madhe të bizneseve e shoqatave që duan të japin kontributin e tyre për një Tiranë më të gjelbër e më të shëndetshme;

3. Rrjeti minimal i biçikletave

Rrjeti Minimal i Bicikletave krijon një skelet me korsi të dedikuara dhe të veçuara nga trafiku për qytetarët që përdorin biçikletën si mjetin kryesor të lëvizjes së përditshme. Janë përfunduar ose drejt përfundimit korsitë e dedikuara në akset kryesore radiale dhe transversale të qytetit: Rrugën e Dibrës, Rrugën e Durrësit, Rrugën e Kavajës, Bulevardin Zogu i Parë dhe Bulevardin Dëshmoret e Kombit, Unazën e parë dhe të tretë të qytetit. Korsitë e dedikuara të biçikletave rrisin në formë eksponenciale sigurinë në rrugë të drejtuesve të biçikletave si dhe rrisin përdorimin e këtij mjete në përditshmëri, duke ulur numrin e përdoruesve të automjeteve me një impakt të drejtpërdrejtë në lëvizshmërinë e trafikut si dhe në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e qytetarëve të Tiranës.

4. Terminalet e Transportit

Janë përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme për të filluar punën në vitin 2018 për ndërtimin e dy termialeve të rinj të transportit, Terminali Jug-Lindor i Tiranës, cili parashikohet të përballojë fluksin e autobusëve dhe furgonëve që hyjnë në Tiranë nga rr. e Elbasanit, përkatësisht autobusët që vijnë nga Korça, Pogradeci, Librazhdi, Përrenjasi dhe Elbasani si edhe autobusët që vijnë nga Maqedonia dhe Terminali tjetër, i cili parashikohet të përballojë fluksin e autobusëve dhe furgonëve që hyjnë në Tiranë nga qytetet jugore, veriore dhe veri – lindore.

Të dy терминаlet do të jenë një ndihmë e jashtëzakonshme në disiplinimin e trafikut në Tiranë dhe lehtësimin e qarkullimit duke shmangur hyrjen në qytet së pari të autobuzëve ndërqytetas e së dyti edhe të shumë prej atyre 60 deri 70 mijë automjete që vizitojnë çdo ditë kryeqytetin nga rrethet, cka do të sigurojnë më pak trafik, por edhe më pak ndotje për Tiranën.

5. Tirana-Një qytet policentrik

Plani i ri i Pergjithshem Vendor i Tiranës parasheh një qytet me 5 qendra të reja urbane në Kombinat, Kinostudio, Laprakë, tek Bulevardi i ri si dhe në Shkozë. Në këto qendra do të merren masa për nxitjen e investimeve private si dhe investime publike të Bashkisë në infrastrukturë sekondare dhe shkolla të reja si qendra komunitare me qëllim përqëndrimin e një mase kritike kapitali në një hapësirë qendore urbane. Kjo qasje do të rrisë cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara në këto zona të ndërlidhura mirë me njëra tjetrën me transport publik si dhe me rrjetin minimal të bicikletave. Bashkërendimi i këtyre do të rrisë aksesin e qytetarëve në shërbime pranë vendbanimeve të tyre si dhe do të krijojë disa qendra të reja me karakteristika të ndryshme nga njera tjetra: qendra universitare, artizanale, artistike, mediatike etj.

Me qëllim hartimin e masterplaneve për Tiranën Policentrike Bashkia Tiranë, do të lançojë gjatë vitit 2018, tre konkurse për tre poliqendrat kryesore të qytetit: Lapraken, Kombinatit dhe Kinostudion. Konkursat do të zhvillohen në rang ndërkombëtar dhe do të finalizohen me një fitues që më pas do të detajojë Planin e Detajuar Vendor të poliqendrës në fjalë. PDV e këtyre zonave do të detajojnë përdorimin e tokës dhe do të incentivojnë investimin privat, por njëkohësisht do të vendosin edhe projektet kryesore të punëve publike për tu implementuar në këto zona me qëllim përqëndrimin e një mase kritike investimi publik dhe privat dhe aktivizimin e tyre si qendra të reja të qytetit.

6. Vazhdimi i projektit i Bulevardit të ri dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës

Bulevardi i Ri - Momentalisht ka përfunduar ndërtimi i Parkimi Nëntokësor si dhe ndërtimi i segmentit të parë nga km 0+000 deri në km 0+400, të cilat janë duke u shfrytëzuar nga qytetarët e Tiranës. Ndërtimi i Parkimit Nëntokësor i ka shtuar qytetit të Tiranës rreth 305 vendparkime të reja, të cilat po menaxhohen nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu është punuar në segmentin e dytë nga km 0+400 deri km 0+800 ku me përfundimin e shtresave asfaltike do të bëhet dhe hapja së shpejti e këtij segmenti për qytetarët e Tiranës. Po vazhdojnë punimet në segmentin e tretë nga km 0+800 deri në km 1+250 ku ka përfunduar rreth 80% e punimeve të ndërtimit. Projekti i “Ndërtimit të Bulevardit Verior të Tiranës” parashikohet të përfundojë brenda vitit 2018. Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Fondin e Abu Dhabit, ka rishikuar projektin e Bulevardit, duke prezantuar dhe projektin e ri për Parkun Qendror të Tiranës, i cili nuk ishte i parashikuar në projektin e vjetër.

Rehabilitimi i Lumit të Tiranës – Deri më sot janë realizuar në masën 98% zërat e punimeve civile dhe hidraulike të kontratës së parë të Rehabilitimit të Lumit që përfshin segmentin nga km 7+100 për të dyja drejtimet, atë të Tiranës dhe Paskuqanit. Kontrata vijuese përfshin km 1+300 dhe kanë përfunduar punimet civile dhe hidraulike në masën 98%. Deri në fund të këtij viti pritet të mbyllen të gjitha punimet civile dhe hidraulike për të dyja kontratat në masën 100% si dhe të vazhdohet me gjelbërimin e zonave të parashikuara.

7. Kopshti Zoologjik

Kopshti Zoologjik është një hapësirë që prej dekadash ka patur nevojë për ndërhyrje thelbësore për të lehtësuar maksimalisht vuajtjet e gjallesave që e popullojnë atë e njëkohësisht për ta transformuar në një hapësirë të re edukative për qytetaret e mbi të gjitha fëmijet e kryeqytetit.

Projekti ynë për kopshtin zoologjik e transformon atë në një hapësirë moderne, ku kafshët nuk janë në kafaz, përkundrazi ato jetojnë në habitatin e tyre dhe janë vizitoret ata që janë të kufizuar nga kafazi. Transformimi gjithashtu e sheh hapësirën si një mundësi më tepër për të edukuar fëmijet duke ulur numrin e kafshëve ekzotike (që kanë kosto dhe standarte shumë më të larta se kafshët e tjera) dhe rritur numrin e kafshëve të fermes, të cilat janë edhe më të afërshme, pra projekti i afrohet asaj që ndërkombëtarisht quhet petting-zoo – nje kopesht zoologjik interaktiv.

Tjetër pikë e rëndësishme e këtij projekti është edhe zgjerimi dhe ndërlidhja me Kopshtin Botanik. Në fazën e fundit të implementimit kopshtet lidhen me një hapësirë të nëndheshme që shërben edhe si një hapësirë për fluturat ose një miniakuarium i nëndheshëm. Në këtë mënyre itinerari i Kopshtit Zoologjik zmadhohet dhe bashkohet edhe me larmishmërinë e florës së Kopshtit Botanik.

8. Piramida

Ndërkohë që Tirana është gati katërfishuar në popullsi pas viteve '90, dhe njohu një bum në ndërtim dhe zhvillim urban, paradoksisht hapsirat publike kushtuar artit dhe kulturës apo shtëpitë e rinisë, dikur ekzistuese, pothuajse u zhdukën. Piramida ka qenë objekti i fundit që arriti të luajë një rol publik sa i përket jetës artistike, kulturore dhe intelektuale. Në fakt Piramida jo vetëm që ishte objekti i fundit, por ishte dhe një pikë nevralgjike e jetës intelektuale të qytetit mbasi me hapsirat e shumta që ofronte kishte mundësi që të mbulonte nevojat e thujtë të gjitha disiplinave por dhe grup moshave.

Është sot i pamohueshëm vakumi që mbyllja e këtij objekti ka krijuar për jetën intelektuale të qytetit si dhe kultivimit të brezave të rinj me dëshirën për artin dhe kulturën.

Qartësimi i vizionit të Piramidës është detyra e parë më e rëndësishme për grupin e punës. Çfarë Piramida do të jetë për Tiranën në vitet e ardhshme është hapi i parë, që dikton më pas programet politikat dhe planet e qendrës.

Në premisën e parë ne biem dakord: **Piramida do të bëhet shtëpia e artit të pavarur në Tiranë**, një vend ku qytetarët vijnë për të praktikuar dhe shijuar art bashkëkohor. Misioni i Piramidës është të ofrojë për qytetarët e Tiranës një hapësirë gjithëpërfshirëse lirie të eksplorimit, ushtrimit dhe mësimi të artit.

Nga momenti që bihet dakort që objekti të cilit i referohemi si “Piramida” të mos përdoret për arsye komerciale, destinacioni i tij bëhet gati vetpërshtues duke qenë se ka një histori suksesi në funksionim që e paraprin. Ky objekt ka potencialin dhe mundësinë që brenda çatisë së tij të përmbledh më të mirën e jetës intelektuale, artistike dhe mendimit novator që kryeqyteti ynë mund të ofrojë.

Ndryshe nga mënyra se si është menaxhuar më parë, ku sensi administrativ dhe koordinativ ka qenë më shumë me karakter kalendarik, modeli i ri nuk do të bazohet vetëm në dhënie hapësirash me qera dhe akomodim aktivitetesh por në një strukturë që prodhon, informon dhe edukon.

➤ **Ndërhyrjet në infrastrukturën e qytetit:**

1. Rrugët dhe Transporti Publik

Investimet brenda këtij programi do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e infrastrukturës rrugore, duke vijuar me aplikimin e standardeve më të larta në gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe do të përbëjnë 39% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2018 – 2020, me një rritje prej 12% në krahasim me planifikimin e vitit 2017.

Gjatë vitit 2018 do të ndërhyhet me sistemim asfaltim në rreth 30,000 m² të infrastrukturës rrugore. Do të rikonstruktohen ose ndërtohen rrugë të reja së bashku me rrjetet inxhinierike rreth 50.000 m², si dhe trotuarë 18.000 m².

Do të synohet rikualifikimi tërësor i gjithë infrastrukturës horizontale dhe vertikale. Gjithashtu, do të pajisen me sinjalistikën e nevojshme korsitë e autobusëve urbanë në unazën e mesme dhe unazën e vogël, si edhe në disa prej rrugëve që lidhen me to.

Modernizimi i transportit publik është, gjithashtu, një prioritet i rëndësishëm dhe në vitin 2018 kur do të testohet dhe zbatohet biletimi elektronik. Për të reduktuar trafikun do të kryhet transferimi i linjave të transportit ndërqytetas dhe ndërkombëtar jashtë unazës së mesme, deri në ndërtimin e terminaleve të udhëtarëve.

2. Arsimi Parauniversitar

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore si dhe ambjentëve ndihmëse e rekreative në të gjitha objektet arsimore, do të përbëjnë 16 % të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2018-2020.

Duke qenë se Bashkia e Tiranës ka parashikuar ngritjen e një skeme të partneritetit publik privat për ndërtimin e 17 shkollave të reja, në këtë program nuk janë parashikuar investime për ndërtimin e shkollave të reja. Me ndërtimin e 10 shkollave të reja 9-vjeçare dhe 7 shkollave të reja të mesme, në qytetin e Tiranës do të marrë fund njëherë e përgjithmonë problemi i mësimit me dy turne. Përmes partneritetit publik privat, shkollat e reja do të ndërtohen me financimin e koncensionarit dhe Bashkia Tiranë do t'i paguajë me këste vjetore për një periudhë 7 vjeçare me anë të të ardhurave të mbledhura nga Taska e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Si rezultat i përmbushjes së nevojës për shkolla të reja, investimet brenda këtij programi do të përqëndrohen kryesisht në rindërtimin e shkollave ekzistuese dhe ndërtimin/rindërtimin e kopshteve dhe çerdheve.

Programi synon jo vetëm 19 shkollave të reja që do t'i japin fund mësimit me dy turne, por do të kthehen edhe në qendra par excellence komunitare me mjediset e tyre sportive dhe ambientet multifunkionale;

Programi ka të parashikuar si objektiv edhe shfrytëzimin e infrastrukturës së objekteve të arsimit parauniversitar pas përfundimit të procesit të mësimit në dobi të nxënësve dhe komunitetit, por edhe mbështetje duke dizenuar dhe aplikuar projekte social-arsimore që ndikojnë dukshëm në edukimin e fëmijëve, një prej të cilëve, projekti “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, i është prezantuar tashmë Këshillit Bashkiak.

Vëmendje maksimale do t'i kushtohet ngrohjes në objektet arsimore. Kësisoj, është parashikuar rehabilitimi i infrastrukturës dhe vendosja në efikasitet të plotë e ngrohjes në të gjitha objektet arsimore.

3. Shërbimet Publike Vendore

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në blloqet e banimit do të përbëjnë 22% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2018-2020, me një rritje prej 18% në krahasim me planifikimin e vitit 2017.

Rehabilitimi i hapësirave publike, shtimi i gjelbërimit në të gjithë territorin e qytetit, krijimi i hapësirave të reja rekreative, rikualifikimi i rrjetit ekzistues të ndriçimit deri në 100% dhe sigurimi i ndriçimit për hapësirat e reja urbane, janë objektivat parësorë të këtij programi për 3 vitet e ardhshme.

4. Kujdesi Social

Parashikimi i buxhetit social, adreson objektivat zhvillimore të Bashkisë Tiranë në fushën sociale, që lidhen drejtpërsëdrejti me zbutjen e varferisë dhe zhvillim ekonomik të shtresave të caktuara. Në ndarjen e zërave të këtij buxheti, disa prej tyre vijnë në rritje si: programet e strehimit social e nxitjes së punësimit, skema të cilat synojnë zhvillim afatgjatë, e disa zëra janë risi buxhetimi sic është projekti “Bllok –ndihma ekonomike deri në 6 %”, projekte këto që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nivelin e mirëqënies së qytetarëve tanë. Koherenca e buxhetimit social në përputhje me nevojat e vlerësuara është qëllimi i programit të kujdesit social.

Është mision yni që t’i sigurojë çdo qytetari të Tiranës, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore.

Shërbimet e parandalimit, ndërhyrjes, mbrojtjes dhe riintegritimit të fëmijëve e familjeve të tyre në rrjedhën normale të jetës social-ekonomike, kjo përmes shërbimeve me bazë komunitare, veçanërisht për fëmijët në situatë rruge, është një nga objektivat madhorë të këtij programi. Këto shërbime gjejnë shprehje buxhetore përmes rritjes së buxheteve të qendrave sociale bashkiake, zgjerimin e hartës së shërbimeve në territorin e njësisë administrative nr. 4 me një qendër të re, shërbime të reja në Qendrën Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, si dhe rifreskimi i marrëveshjes me Organizatën ARSIS, në mundësim të një tipologjie të strukturuar të shërbimeve për fëmijë dhe veçanërisht të shërbimit 24 orë në mbështetje e mbrojtje të tyre.

Gjithashtu, trajtimi i familjeve të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike, por të vlerësuara si familje në ekstremin e varfërisë është një nga zërat buxhetorë që synon mbështetje dhe riintegrim social.

5. Nxitja e Punësimit

Në fushën e nxitjes së punësimit, programet e hartuara synojnë të krijojnë lehtësi për ngritjen e biznesit në mbështetje të sipërmarrësve të rinj apo të grave sipërmarrëse si dhe programi për mbështetjen e karrierës profesionale për të rinjtë e sapodiplomuar, të cilët do të mund të zhvillojnë Praktikën Profesionale pranë një subjekti privat, kohë gjatë së cilës do të marrin një pagë në nivelin minimal.

Ngritja dhe zgjerimi i një biznesi është një mundësi që u ofrohet grave dhe të rinjve të papunë të cilet zgjedhin të zhvillojnë idetë e tyre përmes hapjes ose zhvillimit të një biznesi që ndihmon në vetëpunësim, rritjen e numrit të punësuarve, ofrojnë shërbime për shtresat në nevojë, promovojnë artizanatin, ushqimin e shëndetshëm, mjedisin etj. Objektivi është fuqizimi ekonomik përmes ofrimit të mbështetjes së drejtpërdrejtë për përfshirjen në tregun e hapur të punë.

III. 1. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË SË TIRANËS PËR PERIUDHËN 2018-2020

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë e Tiranës, përbëhen nga:

- I. Të ardhurat e veta;
- II. Transferta e pakushtëzuar.
- III. Transferta e kushtëzuar;
- IV. Huamarrja e qeverisjes vendore;

Për vitin 2018 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë parashikuar në vlerën e 15,115,881,000 lekë me një rritje prej 8% në krahasim me parashikimin e vitit 2017.

Në vitin 2018, masa e transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës është rritur me 12% ose 225,511,256 lekë krahasuar me vitin 2017, duke arritur vlerën 2,138,631,000 lekë.

Në vija të përgjithshme parashikimi i të ardhurave për vitet 2018-2020, paraqitet me këto vlera:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2017	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Të ardhura të taksueshme	7,074,590,000	8,782,500,000	8,923,645,000	8,950,205,800
Të ardhurat jo tatimore	4,789,210,000	4,194,750,000	4,115,180,000	4,202,628,400
	11,863,800,000	12,977,250,000	13,038,825,000	13,152,834,200
Transferta e pakushtëzuar	1,913,119,744	2,138,631,000	2,254,117,170	2,486,290,489
Të ardhura të mbartura	954,645,529	1,200,000,000		
T o t a l i	14,731,565,273	16,315,881,000	15,292,942,170	15,639,124,689

Referuar legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për paketën fiskale vendore të Bashkisë Tiranë, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
- Agjentët tatimorë;
- Tirana Parking.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, e cila jo vetëm arkëton por dhe monitoron të gjitha strukturat e tjera.

Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në arkëtimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre.

Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:

1. Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV;
2. DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
3. ZVRPP, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
4. UKT Sha, për arkëtimin e taksës së ndërtesës, taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe tarifës së pastrimit nga kategoria Familjarë;

Tirana Parking, është struktura e specializuar vetëm për mbledhjen e tarifës së parkimit sipas VKB Nr.48 datë 11.11.2016“Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësie të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”

Në mënyrë të detajuar të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore për parashikimin e vitit 2018 në Bashkinë e Tiranës, paraqiten si më poshtë:

A. Taksa mbi ndërtesën.

Krahas DPTTV që arkëton detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitetet ekonomike në territorin e Bashkisë Tiranë, detyrimin nga kategoria familjarë do vijojë ta arkëtojë UKT Sha, deri në hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të miratuara me ligjin nr. 106 dt. 30.11.2017.


Taksa e pasurisë është ndër burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë së Tiranës dhe përbën 18% të totalit të të ardhurave të veta.

Me VKB është përcaktuar se taksa e ndërtesës për kategorinë familjare do mblidhet nga UKT së bashku me taksën e përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe tarifën e pastrimit duke u reflektuar në faturën e ujit, si një rrugë e cila po jep rezultate të ndjeshme në mbledhjen e këtyre detyrimeve.

Me ndryshimet e fundit ligjore, të cilat marrin efekte nga data 1 Prill e vitit 2018, taksa e ndërtesës do të marrë një tjetër vlerësim, duke u mbështetur tek vlera e banesave dhe % e caktuar për masën e taksës si për banesat dhe objektet e biznesit. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me institucionet qendrore por jo vetëm, ka filluar ngritja e bazës së të dhënave për krijimin e kadastrës fiskale si informacion vendimtar për përlllogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave.

Gjatë viteve 2016 dhe 2017 kjo taksë ka arritur nivelin maksimal të arkëtimit, veçanërisht për kategorinë biznese. Për këtë kategori, performanca është 84% më të lartë se në vitin 2014 dhe 204% krahasimisht me vitin 2013.

	në lekë					
Taksa mbi pasurine	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Biznesi	457,167,375	440,713,939	726,837,103	795,276,949	1,356,525,315	1,407,478,861




Më poshtë paraqitet realizimi në vite i të njëjtës taksë për kategorinë familjarë:

Taksa mbi pasurine	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Familjare	13,765,827	14,174,707	29,918,994	16,879,527	116,857,519	181,151,131

në lekë

Grafikisht:



Në vitin 2018, te ardhura nga taksa janë parashikuar ne vlerën 2,510,000,000 lekë.

Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si më poshtë:

Planifikimi i të ardhurave për periudhën 2018-2020 merr në konsideratë ndryshimet ligjore për këtë taksë për 6-mujorin e dytë të vitit 2018 dhe në vijim.

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	2,510,000,000	3,050,000,000	3,170,000,000
- Familjarët	510,000,000	850,000,000	870,000,000
- Subjektet Tregtare	2,000,000,000	2,200,000,000	2,300,000,000

B. Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nën-kategorizime.

Si rezultat i reformës administrativo – territoriale, Bashkisë së Tiranës i janë shtuar edhe sipërfaqe toke bujqësore.

Vlera e taksës në lekë/hektar/vit sipas kategorive paraqitet si në tabelë:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	5 600
II	4 900
III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII- X	1 800

Ndërkohë parashikimi i të ardhurave nga taksa për vitet 2018-2020, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa mbi tokën Bujqësore	50,000,000	55,000,000	61,000,000

C. Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Per vitin 2018 dhe dy vitet në vijim 2019-2020, parashikimi te ardhurave nga kjo taksë paraqitet në tabelë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa mbi truallin	60,000,000	66,000,000	72,600,000

D. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore të cilat transferojnë të ardhurat nga TTHF e biznesit të vogël në llogarinë e Bashkisë së Tiranës sipas afateve të përcaktuara në ligj.

Spektori i Agjentëve tatimorë cdo muaj ka kryer rakordimin e të ardhurave të realizuara. Parashikimi dhe realizimi 12-mujor paraqitet në tabelën e mëposhtme referuar të dhënave që prej vitit 2012 deri më 2017:

në lekë

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e BV	827,765,270	843,098,519	614,587,151	708,247,686	274,693,674	136,434,252

Bazuar në ecurinë e mbledhjes së tatimit, pritshmërinë e vitit 2017 dhe në rivlerësimin e pritshëm ligjor të tij, parashikimi për vitet 2018-2020, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	170,000,000	175,100,000	180,353,000

E. Taksa për fjetjen në hotel

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, bëhet sipas ndarjes në dy kategori:


- Subjekte hoteleri me 4-5 yje me nivel takse për 350 lekë/dhoma
- Subjekte hotele, bujtine, fjetinë, motel, dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizimin me nivel takse për 140 lekë/dhoma

Megjithë problemet për shkak të mosplotësimit të kuadrit ligjor në vlerësimin mbi bazë yjesh për hotelet, është shënuar një rritje prej 132% në krahasim me arkëtimet e vitit 2015 dhe 160% në krahasim me ato të vitit 2014.

në lekë

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Taksa e fjetjes në hotel	46,329,950	39,845,616	42,060,817	50,480,613	67,327,716	75,466,969

Grafikisht :



Parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes ne hotel për vitet 2018-2020, është si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa e fjetjes në hotel	80,000,000	82,400,000	84,872,000


F. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është mbi 4 herë me e lartë në krahasim me vitin 2012, rreth 87% më shumë krahasuar me vitin 2013 dhe 17% më shumë krahasuar me vitin 2014. Edhe ndaj viteve të mëparshëm realizimi i vitit 2016 është dukshëm më i lartë, ndërsa në vitin 2017 realizimi i kësaj takse është rreth 150% më shumë se viti 2016:

	<i>në lekë</i>					
	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	245,071,462	624,719,373	1,004,842,547	128,325,090	1,234,029,324	3,192,974,712

Grafikisht :



Referuar ecurisë së arkëtimit të taksës por dhe shtrirjes së gjërë të studimeve të detajuara vendore në kuadër të planit të përgjithshëm vendor, për vitin 2018 dhe në vijim edhe për vitet 2019-2020, parashikimet për këtë taksë, paraqiten si më poshtë:

	<i>në lekë</i>		
Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3,200,000,000	2,700,000,000	2,500,000,000

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, kryen edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit me parë të vlerës sipas përcaktimeve ligjore.

G. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e ZVRPP, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.

Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga ZVRPP e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme. Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 1,000 lekë/m² dhe për objektet e biznesit është 2,000 lekë/m². Numri i objekteve që transkriptohen është i lidhur ngushtë me lejet e shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI për ato të legalizuara. Eksperiencia e ZVRPP në bashkëpunim me strukturat vendore, mundëson edhe një parashikim sa më real të taksës mbi kalimin të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Ecuria në vite për këtë taksë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në lekë

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Taksa mbi kalimin të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	274,687,877	296,049,524	260,109,009	325,790,581	366,078,762	276,641,082

Bazuar në informacionin e depozituar ZVRPP, me shkresën përkatëse, parashikimi për vitet 2018-2020, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa mbi kalimin të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	680,000,000	700,400,000	721,412,000

H. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tiranë) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.


Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njërive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njërive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave të realizuar për çdo muaj nga agjenti tatimor DPSHTRR.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura deri në vitin 2017 paraqitet në tabelën e mëposhtme :

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	320,249,987	279,468,676	229,126,388	269,085,695	280,082,106	276,641,082

në lekë

Grafikisht:



Parashikimi për vitet 2018-2020, merr në konsideratë, ndryshimet e fundit ligjore të cilat e kanë ndryshuar pjesën takuese të Bashkive nga 18% të kësaj takse në 25%.

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	380,000,000	391,400,000	403,142,000

në lekë

I. Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat personale në favor të NJQV përfaqësojnë vlerën e 2 % e totalit të të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale që arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Është viti i parë që kjo e ardhur do reflektohet në burimet e të ardhurave të njërive vendore pas ndryshimeve në ligjin për financat vendore. Parashikimi është bazuar në planifikimin e këtyre të ardhurave në Buxhetin e Shtetit 2018, nga Ministria e Financave.

Bashkia e Tiranës, për vitet 2018-2020 ka parashikuar të ardhurat, si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tatmi mbi të ardhurat personale	250,000,000	257,500,000	265,225,000

J. Taksa e tabelës.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve, subjekteve të transportit dhe profesionet e lira.

Taksa e tabelës ndahet në:

- Tabelë për qëllime identifikimi deri 2 m2;
- Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 m2;
- Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim;
- Tabelë reklamimi e thjështë;
- Tabelë reklamimi elektronike;
- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.


Viti 2017 ka shënuar nivelin më të lartë të arkëtimeve nga kjo taksë për 15 vitet e fundit, me një performancë rreth 40% më të lartë krahasimisht me vitet 2014 dhe 2015.

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite pasqyrohet si më poshtë:

në lekë

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Taksa e tabelës dhe reklamës	264,762,861	241,190,949	227,080,832	225,377,938	309,949,842	341,460,152

Grafikisht :



Konkretisht, referuar realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2017, numrit të subjekteve të evidentuara si dhe nivelit të taksës së miratuar sipas ligjit, parashikimi i të ardhurave për vitet 2018-2020, paraqitet në tabelë si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa e tabelës	51,500,000	536,005,000	562,785,000
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	500,000	505,000	510,000
Tabelë reklamuese	510,000,000	535,500,000	562,275,000

K. Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Të ardhurat nga kjo taksë e përkohshme do të përdoren për projektin e ri të ndërtimit të 19 shkollave të reja .

Për periudhën 2018-2020, parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë e përkohshme, është si vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Taksa e përkohëshme për infrastrukturën Arsimore	892,000,000	909,840,000	928,816,800
Familjarët	342,000,000	348,000,000	355,816,800
Subjektet Tregtare	550,000,000	561,000,000	573,000,000

Krahas DPTTV që arkëton detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Tiranë, detyrimin nga kategoria familjarë do vijojë ta arkëtojë UKT Sha.

L. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mbledhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe Ujësjetës-Kanalizime Tiranë Sha për kategorinë familjarë.

Ecuria e arkëtimit të tarifës së pastrimit për të dyja kategoritë si Biznese dhe Familjarë rezultojnë me dy herë më shumë rritje në vitin 2016, se arkëtimet e periudhës 2012-2015 dhe disa herë më shumë se në vitet 2006-2011, si rezultat i riorganizimit të mënyrës së mbledhjes së taksës e forcimit të strukturave menaxhuese.

Në vitet 2015 e 2016 është arkëtuar detyrimi disa-vjeçar që UKT i detyrohej Bashkisë së Tiranës për arkëtimet nga kjo taksë. Kjo është arsyeja pse në vitin 2017, i cili përfaqëson vetëm të ardhurat nga vitet korrent niveli arkëtimeve paraqitet me ulje në krahasim me vitin 2016.


Paraqitja në vite si më poshtë:

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Tarifa e pastrimit Familjarë	324,127,250	337,189,756	339,808,610	353,205,579	680,162,260	541,168,219

E njëjta taksë për kategorinë biznese paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim:

	2012	2013	2014	2015	2016	10-M 2017
Tarifa e pastrimit Subjekte	451,817,355	417,910,122	469,930,528	478,459,466	929,032,867	1,026,891,253

Grafikisht :



Për vitin 2018, parashikimi arkëtimit të tarifës së pastrimit si për subjektet dhe kategoria familjarë, paraqitet si më poshtë :

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tarifa e pastrimit	2,166,000,000	2,070,000,000	2,103,400,000
- Familjarët	836,000,000	730,000,000	750,000,000
- Subjektet Tregtare	1,330,000,000	1,340,000,000	1,353,400,000

Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitet e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve të evidentuara aktiv dhe nivelit të tarifës për vitin ushtrimor, të ardhura që trajtohen nga strukturat e DPTTV e cila në bashkëpunim me njësitë administrative do kryejnë në kohë njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti të ndjekin dhe mbledhjen e tyre.

M. Tarifa për zënien e hapësirave publike

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m2 të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit e indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:


- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj
- Zënia e hapësirës publike ne tregjet publike.

- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike në vitin 2016 janë 3 herë më të larta se arkëtimet e vitit 2015 dhe thuhet 4 herë më të larta se ato të vitit 2014, ndërsa realizimi i pritshëm i vitit 2017 parashikohet rreth 15% më i lartë se viti 2016, paraqitur si mëposhtë:

	2012	2013	2014	2015	2016	<i>në lekë</i> 10-M 2017
Tarifa për zënien e hapësirave publike	58,758,781	56,894,544	60,465,809	65,713,463	280,234,642	314,858,272

Grafikisht :



Parashikimi i të ardhurave të kësaj tarife për vitet 2018-2020, është si më poshtë:

	<i>në lekë</i>		
Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tarifa për zënien e hapësirave publike	490,000,000	500,000,000	500,000,000
Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella.	440,000,000	450,000,000	450,000,000
Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	50,000,000	50,000,000	50,000,000

N. Tarifa e parkimit

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia e Tiranës për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e liçensuara.


Me qëllim evidentimin dhe ndjekjen operacionale të parkimit, territori i Bashkisë Tiranës është detajuar në zona tarifore sipas tipologjive, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre.

Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2016 ka një rritje të dukshme, si rrjedhojë e riorganizimit të strukturave, mënyrës së arkëtimit dhe evidentimit në kohë të përdoruesve të parkimit në rrugët me pagesë por dhe në sheshet e miratuara për parkim. Gjithashtu viti 2017 pritet të ketë një realizim rreth 50% më të lartë se viti 2016, si më poshtë:

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifa e parkimit	78,011,313	76,242,781	67,899,565	71,628,038	205,901,190	292,768,889

në lekë

Grafikisht :



Parashikimet për arkëtimin e tarifës së parkimit për vitet 2018-2020, janë si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tarifa e parkimit te automjeteve	450,000,000	469,980,000	490,883,400
Parkim me kontratë	126,000,000	129,780,000	133,673,400
Parkim me bileta	324,000,000	340,200,000	357,210,000

në lekë

O. Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime

Tarifa paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, për çdo aplikim për leje zhvillimi, infrastrukturë dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Parashikimi i për vitet 2018- 2020, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	220,500,000	235,000,000	240,000,000

P. Tarifa për dhënie licence për tregtim karburanti e lëndë djegëse.

Tarifa për dhënien e licencave të tregtimit të karburantit dhe lëndëve djegëse është detyrim për të gjitha pikat e tregtimit fundor në territorin e Bashkisë Tiranë.

Qëllimi i kësaj tarife është rregullimi i tregut të karburanteve dhe lëndëve djegëse, për një shpërndarje racionale dhe një mirëadministrim të territorit duke shmangur ngritjen e pikave të tregtimit të tyre në afërsi të ndërtesave të banimit, qendrave arsimore dhe institucioneve.

Deri në vitin 2017 janë arkëtuar rreth 80% e detyrimeve nga kjo tarifë, ndërsa pjesa e mbetur pritet të arkëtohet në vitin 2018. Detyrimi për këtë tarifë lind sërish pas 5 vitesh.

Parashikimi i tarifës për vitet 2018-2020, është si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Tarifa për dhënie licence për tregtim karburati e lëndë Djegëse	80,000,000	0	0

Q. Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji.

Parashikimi i të ardhurave për vitet 2018-2020, si më poshtë vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	94,240,000	98,952,000	103,899,600
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	57,760,000	60,648,000	63,680,400

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave ushqimore është Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

Parashikimi i të ardhurave nga pagesa në konviktet e Shkollave të Mesme, për vitet 2018- 2020, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020
Pagesa per Konviktet e Shkollave te Mesme	4,000,000	4,000,000	4,500,000

Niveli i transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar përcaktohet çdo vit në ligjin e Buxhetit të Shtetit.

III.2. Transfertat nga Buxheti i Shtetit

Transferta e Pakushtëzuar


Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" si dhe udhëzimeve plotësues.

Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës në periudhën 2010 – 2018 paraqitet si vijon:

në mijë lekë

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Transferta e pakushtëzuar	863,636	870,786	892,178	1,101,276	1,187,822	1,339,286	1,531,459	1,913,120	2,138,631

Grafikisht:



Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2018, është në masën 2,138,631,000 lekë, me një rritje prej 12%, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Transferta përbën 13% të të ardhurave për vitin 2018.

Për vitet 2019-2020, transferata e pakushtëzuar, referuar parashikimeve të Ministrisë së Financave, do të rritet respektivisht me 5.4% dhe 10.3% në vit.

Transferta e pakushtëzuar duhet t'u sigurojë Njësive të Qeverisjes Vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal).

Në vitin 2018, ashtu sikurse edhe në vitin 2017, transferata e pakushtëzuar do të përdoret për financimin e shpenzimeve operative dhe kapitale, e ndarë respektivisht në 45 % për shpenzimet kapitale dhe 55% për shpenzimet operative.

Transferta e Kushtëzuar

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësive vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitet vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

Shërbimi i gjendjes civile si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Qendrat e Rregjistrimit të Bizneseve, si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative bëhet nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve që bëhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Përkrahja sociale, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministrisa e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

Transferta Specifike

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" do të vazhdojnë të financohen nëpërmjet transfertës specifike edhe në buxhetin e vitit 2018. Më konkretisht:

- Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor
- Personeli mbështetës i arsimit para-universitar
- Rrugët rurale rajonale
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri
- Shërbimi pyjor
- Ujitja dhe kullimi

Ndarja e transfertës specifike, sipas funksioneve për Bashkinë e Tiranës është si më poshtë

në lekë

	Konviktet	Arsimi Parashkollor	Arsimi Parauniversitar	Mbrojtja nga Zjarri	Administrimi i Pyjeve	Rruget Rurale	Ujitja dhe Kullimi
Transferta Specifike	89.011.672	660.439.500	85.553.360	109.163.489	8.048.542	19.433.476	20.429.976

Edhe gjatë vitit 2018, funksionet e transferuara mbeten të njëjtat dhe informacion me të detajuar në lidhje me fondet sipas cdo funksioni mund të gjendet në pasqyrën nr. 3/2 pjesë përbërëse e vendimit.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore, në fushat e infrastrukturës rrugore vendore, arsimit, etj.

Projektet miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, mbi bazën e politikave dhe programeve të Zhvillimit të Rajoneve të Shqipërisë i cili përcakton edhe masën e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore. Komiteti merr vendime bazuar në raportet e sekretariateve teknike të Ministrive të Linjës, të cilat bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, bazuar në VKM nr.135, datë 03.02.2010 për "Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve".

Për vitet 2015-2017 Bashkisë së Tiranës i janë miratuar projekte nga FZHR në vlerën totale prej 4.911.792.549 lekë, të ndara sipas programeve në vazhdim:

Programi i Menaxhimit të Rrugëve

- 1- Ndertimi, rikonstruksion i Unazës së Vogël, Tiranë (seg.Banka e Shqiperise- Ushtari i Panjohur)
- 2- Projekt Pilot i këndit të lojrave për fëmijë në Parkun e Liqenit Artificial të Tiranës
- 3- Rikonstruksion i rrugës "Shote Galica"
- 4- Rehabilitim i 2 blloqeve ndërmjet Rr. "Llazi Miho" dhe "Ali Kelmenti"
- 5- Rikualifikimi i urban i bllokut nr.1 (Lapraka)
- 6- Rikualifikim urban i rrugëve në bllokun e pallateve "Selitë", të kufizuar nga Rr. "Hamdi Pepa", Rr."Ilia Dilo Sheperi", Rr."Visarion Xhuvani" dhe Rr."Leka i Madh" Nja 5
- 7- Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej
- 8- Rehabilitim i varrezave Sharrë dhe lidhja me rrugën ekzistuese Kombinat
- 9- Itenerare këmbësorësh me pistë vrapimi dhe bicikletash në Parkun e Liqenit Artificial
- 10- Rikualifikim i Pazarit të Ri (Markata e Mish-Peshkut, restaurim i 4 objekteve dhe rikonstruksion i fasadave përreth sheshit Avni Rustemi dhe pajisjet)
- 11- Sistem i qendëruar për menaxhimin e hoteleve dhe taksave të qëndrimit në Bashkinë e Tiranës
- 12- Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë e Tiranës
- 13- Linearizimi financiar në institucionet e varesisë të Bashkisë Tiranë
- 14- Sistemi elektronik i inventarizimit, regjistrimit dhe përdorimit të aseteve të Bashkisë Tiranë

- 15- Linearizimi i menaxhimit të aseteve në institucionet e varesisë të Bashkisë Tiranë
- 16- Rikualifikimi urban i Bllokut që kufizohet nga rruga e Elbasanit-Stavri Vinjau-Pjeter Budi dhe Ali Visha NJA2
- 17- Rikualifikimi urban i Bllokut të kufizuar nga Rr. "Llambi Bonata", Rr. "Haki Stermilli" "Musine Kokalari" dhe rikonstruksioni i rrugës "Zyber Zeneli" NJA6
- 18- Korsi Bicikletash në rrugën e Kavajës dhe rrugën e Dibrës
- 19- Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën "Reshit Petrela" me rrugën "Skender Kosturi"
- 20- Sistem i qëndëruar për monitorimin e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimin e kontrollit

Programi i Arsimit Parauniversitar & Edukimi

- 1- Rikualifikim i terrenit sportiv në shkollën "Petro Nini Luarasi"
- 2- Rikonstruksion Liceu Artistik "Jordan Misja"
- 3- Rikonstruksion i Shkollës koreografike Tiranë
- 4- Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë auditorit të Liceut Artistik "Jordan Misja"
- 5- Rikonstruksion, shtese anesore 2 kate dhe palester për shkollën e mesme të komunës Vaqarr
- 6- Ndërtim i shkollës 9 vjeçare "Kosova" Tiranë
- 7- Ndërtim i shkollës 9 vjeçare fshati Mihajas
- 8- Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare "Dora D'istria"

Informacion me i detajuar në lidhje me fondet Nga FZHR mund të gjendet në ankesin 1 bashkëlidhur vendimit.

III.3. Burime te tjera financimi / Donacione

I. Donatorë lokalë

Mbështetur në programin e ngritjes së fondeve dhe në procesin e bashkëpunimit me donatorët dhe partneritetit publik-privat, Bashkia e Tiranës në përputhje me prioritetet dhe nevojat për financimin e projekteve, ka gjetur mbështetjen e donatorëve potencialë. Këto donacione janë realizuar nëpërmjet financimit të tyre në forma të ndryshme si: sponsorizime, dhurime, grante, ndihma humanitare, marreveshje bashkëpunimi, etj.

Në periudhën 2 vjeçare Bashkia Tiranë ka arritur të ngrëjë fonde donatore në vlerën 655,467,992 lekë për projekte specifike dhe ka realizuar 513 bashkëpunime të frytshme për financimin dhe realizimin e projekteve si më poshtë :

<i>në lekë</i>			
Nr.	Emërtimi i bashkëpunimit/ projektit donator	Numri i Kontratave	Vlera e donacioneve
1	Projekti "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht"	191	158,246,688
2	Projekti i gjelbërimit, mbjelljet e reja në Tiranë, mobilim urban, rehabilitim i mjediseve publike, etj	138	108,363,554
3	Projektet e investimit në infrastrukturë, shkolla, rrugë, sinjalistike, etj	79	224,304,811
4	Dhurim automjete, pajisje, kompjutera, etj	51	67,995,225
5	Ndihma humanitare, projekte sociale, kulturore, etj	53	19,932,614
6	Marrëveshje bashkëpunimi, Programe Financimi, Grante, etj	1	76,625,100
Totali		513	655,467,992

Projektin "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht" janë sukseset më të mëdha të këtij procesi. Donatorët e ndryshëm, kompanitë e ndërtimit apo biznese të ndryshme, pa harruar edhe qytetarë të thjeshtë, kanë ofruar si kanë pasur mundësi për të sjellë në një funksion të admirueshëm situatën e këtyre ambienteve të fëmijëve. Ndërhyrjet kanë konsistuar në: heqjen e lagështirës, rikonstruksione të pjesshme, lysterje të mureve të brendshme dhe të jashtme, vendosje kondicionerësh, mobilime të ndryshme në krevatë, dyshekë, tavolina, karrike e shumë e shumë produkte të tjera, kompletimi i tualeteve si dhe kuzhinës me pajisje bashkëkohore dhe për fëmijët e kësaj moshe, etj. Gjithashtu ndërhyrje ka pasur edhe në ambientet e jashtme, sistemime të ndryshme, rregullimi i trotuareve, lysterje fasade, mbjellje frutash, perimesh, lule, vendosja e këndeve të lojrave, etj. Në këtë kuadër janë realizuar 191 kontrata me donatorët dhe është përthithur shuma prej 158,246,688 lekësh, duke siguruar ndërhyrjen në pothuaj të gjithë këto godina.

Për rehabilitimin e lulishteve, mbjellje të ndryshme në parqet dhe rruget e Tiranës, sipas planifikimit për pyllëzimin e Tiranës dhe rritjen e frymëmarrjes së kryeqytetit, mobilim urban, etj, në bashkëpunim dhe koordinim të nevojave dhe zbatimit të tyre me APR dhe DPN1PQ, si dhe në kuadër të nismave: "Pyllëzimi i Tiranës", "Luaj Tirana", "Mbill pemën tënde", "Dhuro një pemë", "Dhuro një stol" etj, janë realizuar 138 kontrata për projekte me fonde donatore në vlerën 108,363,554 lekë.

Projektet e investimit në infrastrukturë, në kuadër të mbështetjes së donatorëve kanë konsistuar në ndërhyrjet e realizuara për rikonstruksione të shkollave (hidrozolim tarracës, rehabilitim të lagështirës së klasave, rregullim të suvasë, të tualeteve, vendosje të sistemit ngrohës, paisje me kompjutera, mobilje, mjete mësimore si edhe laboratorët, etj), rehabilitimeve në rrugë, vendosjen e sinjalistikave apo kangjellave mbrojtëse, instalimin e ndricimit të teknologjisë inteligjente LED, risuvatimin e fasadave të pallateve, risistemimin e shtratit të lumenjve apo urave të ndryshme, etj. Donatorët kanë qenë të shumtë, dhe kanë ofruar jo vetëm mbështetjen e tyre financiare por edhe ekspertizën për projekte të ndryshme specifike sipas fushës së tyre që operojnë dhe në mbështetje të nevojave të ndërhyrjeve dhe projekteve të Bashkisë Tiranë. Janë koordinuar 78 kontrata me sponsorizime nga donatorët për projekte dhe është përthithur shuma e financimit në vlerën 224,304,811 lekë.

Donatorët, në kuadër të përgjegjësisë sociale të bizneseve të tyre, korporatave apo dhe individëve që kanë ndihmuar i janë përgjigjur nismave të Bashkisë për të ndihmuar shtresat në nevojë si fëmijët me aftësi të kufizuar apo të moshuarit, ose cdo familje në Tiranë në rastet e emergjencave, si për mbushjen e magazinave të emergjencave të qytetit apo për realizimin e aktiviteteve bamirëse e komunitare dhe të furnizimit të përditshëm me ushqime në menca sociale të qytetit

Gjithashtu është siguruar mbështetje për pajisje të ndryshme në ndihmë të administratës, policisë bashkiake, zjarrfikëseve etj.

II. Donatorë të huaj

Bashkia Tiranë, në vijim të aplikimeve për financime apo grante nga thirrjet dhe programet e projekteve të donatorëve ndërkombëtarë e bilateral, si edhe me Komisionin Evropian, ka arritur të fitojë disa projekte dhe të lidhë Marrëveshje Bashkëpunimi me potencial financimi të konsiderueshme, si dhe është në pritje të rezultateve të seleksionimit për disa prej tyre.

Një listë më e detajuar e këtyre projekteve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Raport mbi projektet e aplikuara	Statusi i projektit	Financimi
1	Projekti "Shelter Tirana for the Home"	Aplikim ne thirrjen per propozime (Programi IADSA)	I fituar ne vleren 33,844,588 Leke
2	Cooperazioni Italian	Detailed local plan (orbital forest)	Miratuuar, ne pritje te lidhjes se marreveshjes 100.000 eur
3	Projekti INDUSTRY 4.0	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
4	Projekti INNO CRAFT	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
5	Projekti LACIAM -Local Agriculture Cluster among Italy,Albania and Montenegro	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
6	Projekti TOUR. I AM - Tourism in Italy,Albania and Montenegro	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
7	Projekti TourVILL	Aplikim si Lead partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
8	Projekti Orbital Forest	Aplikim si Lead partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
9	Projekti Nature -Based Solutions for Low Carbon and Cool cities	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
10	Projekti Networking of Energy Efficiency in the Adriatic Region	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
11	Ecodtr : Eco Demand Responsive Transport	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
12	Projekti Dynamic Mobilization 2.0	Aplikim si partner asociuar ne thirrjen per propozime (Programi IPA CBC Itali-Shqiperi-Mal i Zi)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
13	Projekti AIRTHINGS	Projekt ne fushen e mjedisit per monitorimin e cilesise se ajrit (Interreg Ballkan Med Program)	I fituar ne vleren 148,296 euro
14	Projekti BAS - Benefit As you Save	Aplikim per thirrje per propozime (Programi Interreg Ballkan Med)	I fituar ne vleren 96,000 euro
15	Projekti EU - NITE	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime ne programin Europa per Qytetaret (Europe For Citizens)	Ne pritje te rezultateve te seleksionimit
16	Projekti START ex UP	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi Interreg Ballkan med)	Projekt ka kaluar fazen e dyte te perzgjedhjes
17	Projekti SMILE -First and last Mile Inter-modal mobility in congested urban areas of Adria Region	Aplikim si partner ne thirrjen per propozime (Programi Interreg ADRION)	I fituar ne vleren 109,579.2 euro
18	Projektin e rehabilitimit të 60 banesave sociale për komunitetin rom në Shkozë	IADSA	I levruar ne vleren 76,625,100 Leke

III.4 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN 2018-2020

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2018-2020, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 16,315,881,000 lekë, 15,292,942,170 lekë dhe 15,639,124,689 lekë.

Në parashikimet e vitit 2018 është përfshirë edhe fondi që do të mbartet nga viti 2017. Fondet e mbartura përbëjnë fondet e papërdorura në vitin respektiv të arkëtimit të tyre, ku përfshihen të ardhurat nga dy burime financimi, të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar.

Mospërdorimi i këtyre fondeve ka ardhur si rezultat i faturimeve të grumbulluara në ditët e fundit të vitit, të cilat ka qenë e pamundur të procesohen brenda 2017 për shkak të ngarkesës së fundvitit në Degën e Thesarit dhe do të procesohen në muajin janar 2018.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për vitet 2018-2020, parashikohen të ndara sipas programeve buxhetore si më poshtë:

<i>në lekë</i>						
Nr.	Programi	Viti 2017	Viti 2018	% (strukturë)	Viti 2019	Viti 2020
1	Shërbimet Publike Vendore	4,290,300,205	4,801,088,106	29%	4,275,112,019	4,217,835,620
2	Menaxhimi i Rrugëve dhe Transportit Publik	3,372,891,247	3,470,766,902	21%	3,604,697,862	3,176,639,917
3	Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	2,307,349,211	2,482,213,319	15%	2,498,404,944	2,798,880,837
4	Kujdesi Social	372,621,466	365,915,365	2%	270,403,582	277,183,630
5	Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	598,794,808	1,247,579,109	8%	868,200,277	1,055,788,040
6	Zhvillimi Ekonomik vendor, zhvillimi rural, bujqësor dhe pyje	131,600,000	198,526,388	1%	141,735,945	134,085,523
7	Zhvillimi i kulturës dhe turizmit	288,481,009	216,916,599	1%	222,518,242	227,636,290
8	Rinia dhe Sporti	205,707,273	213,812,244	1%	173,675,470	170,414,993
9	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	2,622,731,934	2,747,013,709	17%	2,644,170,694	2,978,203,484
10	Siguria Publike	533,787,000	572,049,258	4%	594,023,135	602,456,355
11	Ujesjelles kanalizime	7,301,120	0	0%	0	0
TOTALI		14,731,565,273	16,315,881,000		15,292,942,170	15,639,124,689

III.4.1 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik


Sipas shpërndarjes së kryer nga fondet të Bashkisë së Tiranës dhe fondeve nga buxheti i shtetit, ka patur një ndarje të klasifikimit ekonomik sipas zërave të më poshtëm:

Shpërndarja sipas klasifikimit ekonomik është bërë si më poshtë, ku peshën më të madhe e zënë shpenzimet operative dhe ato të personelit me 57%.

në mijë lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2017	Plan 2018	%	Plan 2019	Plan 2020
Shpenzime personeli	3,711,194.534	4,178,355.749	25%	4,261,922.864	4,389,780.550
Shpenzime te tjera operative	4,820,611.809	5,173,269.638	32%	5,145,414.180	5,456,256.031
Shpenzime kapitale	6,199,758.930	6,964,255.613	43%	5,885,605.126	5,793,088.108
TOTALI	14,731,565.273	16,315,881.000		15,292,942.170	15,639,124.689

Paraqitje grafike e realizimit të shpenzimeve të vitit 2018:



Raporti mes shpenzimeve korente dhe atyre kapitale është respektivisht 57% me 43% për vitin 2018. Në periudhë afatmesme synohet rritja e këtij raporti në favor të investimeve çdo vit.

III.4.2 Shpenzimet kapitale

Për vitin 2018 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 6,964,255,613 lekë ose 43% ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2019 dhe 2020, buxheti i investimeve parashikohet respektivisht 5,885,605,126 lekë dhe 5,793,088,108 lekë

Shpenzimet kapitale janë rritur me 12% në krahasim me vitin 2017.

Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitet 2018-2020, sipas programeve buxhetore:

Në mijë lekë

	Programi	Plan 2017	Plan 2018	%	Plan 2019	Plan 2020
1	Shërbimet Publike Vendore	1,592,824	1,879,383	27%	1,246,176	1,025,017
2	Menaxhimi i Rrugëve dhe Transportit Publik	2,437,199	2,506,405	36%	2,604,999	2,130,098
3	Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	1,053,704	938,004	13%	902,717	1,134,635
4	Kujdesi Social	102,358	90,535	1%	20,490	15,520
5	Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	598,795	1,158,579	17%	868,200	1,055,788
6	Zhvillimi Ekonomik vendor, zhvillimi rural, bujqësor dhe pyje	15,000	3,000	0%	12,000	-
7	Zhvillimi i Kulturës dhe Turizmit	47,260	29,987	0%	22,500	13,500
8	Rinia dhe Sporti	65,936	113,397	2%	69,002	60,239
9	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	281,581	228,083	3%	113,786	343,292
10	Siguria Publike	5,103	16,881	0%	25,734	15,000
	TOTALI	6,199,759	6,958,256		5,885,605	5,793,088

III.4.3. Shpenzime për Personelin

Kërkesat gjithnjë e në rritje, problematikat por edhe sfidat që ndeshen për mirëmenaxhimin e territorit të qytetit të Tiranës si dhe zgjerimin e funksioneve të reja të transferuara së fundmi, kërkojnë rritjen e numrit të personelit në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe disa prej njesive organizative në varësi të këtij institucioni.

Ky miratim është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Rritjen e efikasitetit dhe e performancës së strukturave organizative.
- Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve procedurale.
- Përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
- Koordinimin e administrimit territorial.
- Realizimin e plotë të objektivave.
- Maksimizimin e luftës kundër evazionit fiskal.

Në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe tek Njësitë Administrative do të shtohen në total 32 punonjës.

Efektet financiare pas miratimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për BT janë 37,012,000 Lekë.

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit

Miratimi i punonjësve me kontrate të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit sollti një përmirësim në menaxhimin e proceseve të punës në Drejtorinë e Pastrimit të Qytetit, Drejtorinë e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, dhe Sektori e Flota, Transportit. Me shumë vështirësi është bërë e mundur mbajtja nën kontroll pastërtine e rrugëve dytësore e blloqet e banimit në 24 njesi administrative të bashkisë së Tiranës.

- Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, sipas grafikut të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit kryen shërbime në;
 - Sip. totale për Njësitë Administrative 4.397.072 m²

- Sip. totale për 13 ish Komunat 1.590.000 m²
- Sip. totale për Lulishtet 154.999 m²
- Sip. totale për Autostradën 105.000 m²
- Sip. totale për Tregjet 284.412 m²
- Sip. totale për Lumin Lana 104.039 m²

Norma ditore për një punëtor në firma private është 6.000 m², ndërsa norma ditore për një punëtor në Drejtorinë e Pastrimit të Qytetit është aktualisht 41.472 m²

- Drejtoria e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit ka në inventarin e saj lulishte, sheshe, gjelbërim rrugor, kosha, stola dhe basene ujore. Shtimi i sip. të gjelbërta kërkon shtim të numrit të fuqisë punëtore.

Duke menduar të mbahet i njëjti rritëm pune dhe cilësisë së shërbimit propozohet që; Numri i punonjësve me kontratë të caktuar prej 75 punonjësish, që u miratuan me VKB Nr. 50, datë 31.05.2017, i cili ishte efektiv për vitin 2017 për një periudhë 7 mujore, të miratohet si numër punonjësish me kontratë pune me afat të pacaktuar, 50 punonjës, për shkak të fluksit të lartë të punëve që përballon kjo drejtori.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për D.P.Nr.1P.Q., do të jenë 28,478,000 Lekë

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit

Fokusi dhe objektivi kryesor i punës së Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në;

- ✓ mirëmbajtjen me efikasitet të rrugëve rurale, sipas inventarit të tyre dhe administrimin e ujrave në të gjitha njësitet administrative
- ✓ mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik dhe vënien në efikasitet 100% të rrjetit semaforëve dhe sinjalistikës rrugore, në të gjitha njësitet administrative
- ✓ përballimin e të gjithë situatave të përditshme dhe emergjente, që realizohen me mjetet aktuale dhe shtesë të transportit, të disponueshme në parkun e makinerive të drejtorisë, për mirëmbajtje, ndriçim-sinjalistikë, kullim, rrugë rurale.

Për sa më sipër, për mbarëvajtjen e kërkesave dhe funksioneve të shtuara në të gjitha drejtoritë, për burime njerëzore, për përpunimin e të dhënave dhe treguesve statistikore për personel të kualifikuar në sektorin e prodhimit si rezultat i volumeve të shtuara të punës u evidentua domosdoshmëria e riorganizimit të punës propozohet; Shtimi me 10 punonjës në kuadër të mirëfunksionimit të punës; a) mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik, b) përballimi i emergjencave, c) përballimi i kërkesave dhe funksioneve në të gjitha drejtoritë për "IT".

Me VKB Nr. 50, datë 31.05.2017 u miratua numri i punëtorëve me kontratë të caktuar prej 50 punonjësish dhe propozohet të mbahet i njëjti numër për të siguruar të njëjtin rritëm pune dhe menaxhimin e situatës së pastrimit të kanaleve dytësore kulluese për periudhën para ardhjes së stinës së verës.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për D.P.Nr.2P.Q., do të jenë 6,772,000 Lekë.

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit

Politikat dhe objektivat që Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve kërkon të realizojë në riorganizim të saj, për t'ju përgjigjur më mirë sfidës që sjell reforma administrative territoriale, përmes zgjerimit të territorit dhe amalgamimit të zonave të reja në Bashkinë e Tiranës, si dhe shtimit të numrit të objekteve ndaj të cilave kërkohet shërbime (mirëmbajtja e objekteve me karakter social si kopshte, shkolla, çerdhe, në zonën interurbane, privatizimi i banesave shtetërore etj.) bën të nevojshëm shtimim e një numri prej 15 punonjësish kryesisht në nivel Specialistë, punëtorë etj.

Gjithashtu, për ta kthyer shkollën vatër të zhvillimit rajonal dhe një pikë të rëndësishme të projektimit të të gjithë zhvillimit komunitar dhe formimit të qytetarëve të rinj, propozohet që pranë tyre të funksionojnë 50 Administratorë/Përgjegjës mirembajtjeje shkolle (një për çdo dy shkolla) të cilët do të jenë urë lidhëse midis bordit të shkollave dhe njësisë përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit për të bërë të mundur përmiresimin e mirëmbatjes së shkollave si edhe në të njëjtën kohë vënien sa më në efikasitet të të gjitha investimeve të kryera gjatë kësaj periudhe për të gjithë komunitetin rreth e qark shkollës.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për D.P.Nr.3 P.Q., do të jenë 43,462,000 Lekë.

Qendra Kulture "Tirana"

QKT gjatë vitit 2017 ka shtuar në mënyre të ndjeshme numrin e shfaqjeve për fëmijë të grupmoshave të ndryshme duke bërë të mundur afrimin e artit tek femijet, e sidomos shtimin e dëshires së tyre për t'u aktivizuar në performanca të ndryshme artistike. Aktualisht shtimi i numrit të shfaqjeve ka sjellë sipasojë mospërballimin e punës me punonjësit aktualë të Qendrës Kulture "Tirana", ndaj për të ruajtur e rritur cilësinë e numrin e shfaqjeve për vitin 2018 kërkohet shtim i numrit të punonjësve të kësaj qendre, në total 5 punonjës.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për QKT do të jenë 4,673,000 Lekë.

Qendra Rinore "TEN"

Kjo qendër ka prioritet për të stimuluar, nxitur dhe përkrahur impenjimin profesional të të rinjve të pa dhe sapo diplomuar, për shtimin e jetës kulture, sociale, dhe shoqërore të rinisë në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë së Tiranës me synimin për krijimin e një ambienti të vënë në shërbim të të rinjve, si strukturë në dispozicion të të rinjve dhe të aktiviteteve të ndryshme të organizuara prej tyre. Struktura e kësaj qendre është propozuar të zgjerohet me 3 punonjës, për shkak se gjatë vitit 2018 është parashikuar zgjerimi i aktiviteteve në komunitet dhe në disa njësi administrative.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për **Qendrën Rinore "TEN"** do të jenë 2,024,000 Lekë.

Tirana Parking

Nisur nga nevojat emergjente të Tirana Parking, pas plotësimit të strukturës organizative me stafin e parashikuar sipas VKB Nr.48 datë 11.11.2015, nga kërkesat gjithmonë e në rritje të shërbimit të parkimit publik me pagesë që administrohen nga ky Institucion, propozohet të rritet numri i punonjësve në Drejtorinë e Administrimit të Shërbimit me Pagesë (10 Punonjës Shërbimi). Kjo kërkesë vjen dhe si rezultat i:

- Planit për vendosjen nën administrim me pagesë të 69 rrugëve të miratuara sipas VKB Nr. 49 datë 11.11.2015 për vitin 2018, * Shtimit të shërbimit në dy sheshe nëntokësore 24 orë në 7 ditë të javës.
- Shtimit të shesheve të tjera me shërbim 24 orë në 7 ditë të javës;
- Ofrimit të shërbimeve në stacionet provizore - Linjat Ndërkombëtare dhe të Kosovës (shërbim 24 orë në 7 ditë të javës) - Linjat e Jugut (shërbim 18 orë në 7 ditë të javës) - Linjat e Juglindjes (shërbim 18 orë në 7 ditë të javës).

Sipas përlogaritjeve të kryera, për plotësimin e kushteve të punës në zbatim të Kodit të Punës për stafin aktual, si dhe ofrimit të një shërbimi sa më cilësor për qytetarët kërkohet shtim i numrit të personelit të këtij institucioni, në *total* 10 punonjës.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për Institucionin “Tirana Parking” do të jenë 7,083,000 Lekë

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Bazuar në eksperiencën e vitit 2017, performancën dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore nga DPTTV-Tiranë për efekt të përmirësimit të punës është i nevojshëm shtimi i numrit të punonjësve, në total **10 veta**.

Ky shtim i numrit të punonjësve është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Rritjen e efikasitetit dhe performancës së strukturës organizative.
- Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve procedurale.
- Përmirësimin e shërbimit ndaj taksapaguesve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
- Kordinimin më të mirë të administrimit territorial.
- Realizimin e plotë të objektivave.
- Maksimizimin e luftës kundër evazionit fiskal.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2018, për Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore do të jenë 11,106, 000 Lekë.

III.4.4 Shpenzimet Operative dhe të tjera

Shpenzimet operative dhe të tjera janë parashikuar në shumën 5,173,269,638 lekë për vitin 2018, 5,145,414,180 lekë për vitin 2019 dhe 5,456,256,031 lekë për vitin 2020. Këto shpenzime përbëjnë 32% të totalit të buxhetit për vitin 2018 dhe përbëhen nga:

- Shpenzimet operative të aparatit të Bashkisë dhe institucioneve në varësi;
- Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës;
- Transferta të tjera për individët

Për periudhën afatmesme 2018-2020, Fondi rezervë dhe ai i Kontigjencës, është llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Këto fonde do të përdoren sipas përcaktimeve ligjore:

Fondi Rezervë do të përdoret për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak;

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Transferrat për individët përbëhen nga transfertat në mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i qerasë, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë si pagesa për bebet, të cilat do të vazhdojnë të paguhen edhe gjatë vitit 2018.

Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në rritjen e financimit për shërbimet publike me qëllimin e përdorimit të tyre për përmbushjen e funksioneve kryesore të Bashkisë së Tiranës.

Shpenzimet operative shënojnë një rritje prej 7% në krahasim me vitin 2017 dhe ruajnë të njëjtin trend rritës për dy vitet e ardhshme.

Megjithëse në vazhdimësi synohet rritja e peshës së financimit të shpenzimeve kapitale, ekperiencia e vitit të fundit ka treguar se nëpërmjet shërbimeve direkte dhe fleksible sa më afër qytetarëve dhe nevojave të tyre, janë arritur rezultate të shkëlqyera nëpërmjet punës së ndërmarrjeve të Bashkisë Tiranë.

Peshën më të madhe në shpenzimet operative e mbajnë funksionet prioritare të Bashkisë së Tiranës: shërbimet publike vendore, arsimit parauniversitar dhe mirëmbajtja e rrugëve, pasuar nga kujdesi social dhe zhvillimi ekonomik vendor, shpenzime të cilat financojnë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, duke mbajtur fokusin në uljen e shpenzimeve administrative.

Shpenzimet operative dhe të tjera për vitet 2018-2020 parashikohen sipas programeve buxhetore si më poshtë:

në mijë lekë

	Programi	Plan 2017	Plan 2018	%	Plan 2019	Plan 2020
1	Shërbimet Publike Vendore	1,927,982.089	2,068,226.000	0.400	2,158,387.300	2,296,153.538
2	Menaxhimi i Rrugëve dhe Transportit Publik	555,582.232	535,000.000	0.103	561,750.000	595,455.000
3	Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	717,369.629	859,800.000	0.166	897,590.000	945,205.400
4	Kujdesi Social	201,647.680	194,727.000	0.038	167,646.880	176,929.693
5	Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	0.000	89,000.000	0.017	0.000	0.000
6	Zhvillimi Ekonomik vendor, zhvillimi rural, bujqësor dhe pyje	97,000.000	161,716.638	0.031	95,250.000	98,565.000
7	Zhvillimi i Kulturës dhe Turizmit	205,830.115	145,000.000	0.028	157,250.000	170,085.000
8	Rinia dhe Sporti	116,598.000	75,000.000	0.014	78,750.000	83,475.000
9	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	917,050.944	977,540.000	0.189	958,167.000	1,015,527.020
10	Siguria Publike	74,250.000	67,260.000	0.013	70,623.000	74,860.380
11	Ujesjellës kanalizime	7,301.120				
	TOTALI	4,820,611.809	5,173,269.638		5,145,414.180	5,456,256.031

Bilanci përmbljedhës i të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara për periudhën 2018 – 2020 paraqitet në tabelën si më poshtë:

Në mijë lekë

Emërtimi		PARASHIKIMI 2017	PARASHIKIMI 2018	PARASHIKIMI 2019	PARASHIKIMI 2020
I	Të ardhura të taksueshme	7,074,590.000	8,782,500.000	8,923,645.000	8,950,205.800
1	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	1,835,767.000	2,510,000.000	3,050,000.000	3,170,000.000
a	Familjarët	235,767.000	510,000.000	850,000.000	870,000.000
b	Subjektet Tregtare	1,600,000.000	2,000,000.000	2,200,000.000	2,300,000.000
2	Taksa mbi token Bujqesore	25,000.000	50,000.000	55,000.000	61,000.000
3	Taksa mbi truallin	45,000.000	60,000.000	66,000.000	72,600.000
4	Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	231,000.000	170,000.000	175,100.000	180,353.000
5	Taksa e fjetjes në hotel	150,000.000	80,000.000	82,400.000	84,872.000
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	2,700,000.000	3,200,000.000	2,700,000.000	2,500,000.000
7	Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e j	415,000.000	680,000.000	700,400.000	721,412.000
8	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	291,000.000	380,000.000	391,400.000	403,142.000
9	Taksa mbi te ardhurat personale	0.000	250,000.000	257,500.000	265,225.000
10	Taksa e tabelës	501,000.000	510,500.000	536,005.000	562,785.000
a	Tabelë identifikuese/sinjalizuese	1,000.000	500.000	505.000	510.000
b	Tabelë reklamuese	500,000.000	510,000.000	535,500.000	562,275.000
11	Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	880,823.000	892,000.000	909,840.000	928,816.800
	Familjarët	330,823.000	342,000.000	348,840.000	355,816.800
	Subjektet Tregtare	550,000.000	550,000.000	561,000.000	573,000.000
II	Të ardhura jo tatimore	4,789,210.000	4,194,750.000	4,115,180.000	4,202,628.400
1	Tarifat	4,106,710.000	3,414,500.000	3,282,980.000	3,342,283.400
a	Tarifa e pastrimit	2,422,710.000	2,166,000.000	2,070,000.000	2,103,400.000
a.1	Familjarët	1,022,710.000	836,000.000	730,000.000	750,000.000
a.2	Subjektet Tregtare	1,400,000.000	1,330,000.000	1,340,000.000	1,353,400.000
b	Tarifa e parkimit te automjeteve	450,000.000	450,000.000	469,980.000	490,883.400
b.1	Parkim me kontratë	100,000.000	126,000.000	129,780.000	133,673.400
b.2	Parkim me bileta	350,000.000	324,000.000	340,200.000	357,210.000
c	Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	210,000.000	220,500.000	235,000.000	240,000.000
d	Tarifa dhenie licence tregtim karburanti +Lende djege	400,000.000	80,000.000	80,000.000	80,000.000
e	Tarifa për zënien e hapësirave publike	610,000.000	490,000.000	500,000.000	500,000.000
e.1	Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni,kangjella.	530,000.000	440,000.000	450,000.000	450,000.000
e.2	Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	80,000.000	50,000.000	50,000.000	50,000.000
f	Tarifa e shërbimit veterinarë	6,000.000	3,000.000	3,000.000	3,000.000
g	Tarifa shërbimi te MZSH	8,000.000	5,000.000	5,000.000	5,000.000
2	Të ardhura të tjera	484,500.000	624,250.000	668,600.000	688,265.000
a	Qera ndertese	34,000.000	58,000.000	63,800.000	66,990.000
b	Qera trualli	3,500.000	7,500.000	8,250.000	9,075.000
c	Te tjera	362,000.000	420,000.000	430,000.000	440,000.000
d	Nga institucionet e varesise	85,000.000	138,750.000	166,550.000	172,200.000
3	Pagesa	198,000.000	156,000.000	163,600.000	172,080.000
a	Per kopshtet e femijeve	122,000.000	94,240.000	98,952.000	103,899.600
b	Per çerdhet e femijeve	72,000.000	57,760.000	60,648.000	63,680.400
c	Per Konviktet e Shkollave te Mesme	4,000.000	4,000.000	4,000.000	4,500.000
	Shuma	11,863,800.000	12,977,250.000	13,038,825.000	13,152,834.200
	Transferta e pakushtezuar	1,913,119.744	2,138,631.000	2,254,117.170	2,486,290.489
	Te mbartura	954,645.529	1,200,000.000		
	Totali i të ardhurave	14,731,565.273	16,315,881.000	15,292,942.170	15,639,124.689
I.	Shpenzime Korrente	8,458,634.023	9,211,625.387	9,260,337.044	9,690,216.581
1	Personeli (Paga dhe Sigurime Shoqerore)	3,711,194.534	4,178,355.749	4,261,922.864	4,389,780.550
2	Shpenzime per interesa	10,000.000	88,000.000	87,000.000	85,000.000
3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	4,435,568.128	4,613,368.238	4,642,434.180	4,938,363.231
4	Transferta Individe	252,769.174	298,853.400	235,250.000	242,679.000
5	Transferta të brendshme	49,102.187	33,048.000	33,730.000	34,393.800
6	Transferta jashtë	0.000	0.000	0.000	0.000
II.	Fondi Rezervë, Kontigjenca	73,172.320	140,000.000	147,000.000	155,820.000
1	Fondi Rezervë	63,172.320	120,000.000	126,000.000	133,560.000
2	Fondi Kontigjenca	10,000.000	20,000.000	21,000.000	22,260.000
III	Shpenzime Kapitale	6,199,758.930	6,964,255.613	5,885,605.126	5,793,088.108
	Financim i Brendshëm	0.000	0.000	0.000	0.000
	Totali i shpenzimeve	14,731,565.273	16,315,881.000	15,292,942.170	15,639,124.689